Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike

# Projektligjit Për krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Postuar më: 08.08.2019

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka iniciuar projektligjin "Për krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor". Ky projektligj synon krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor, i cili është i domosdoshëm për tregun hekurudhor shqiptar dhe synon garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun hekurudhor.

Ky Projektligj gjithashtu ka si objektiv kryesor plotësimin e akteve ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 142/2016 "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", të cilat mundësojnë aktualisht zbatueshmërinë të këtij ligji.

Ligji Nr. 142/2016, "Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" përcakton në Nenin 55/1 Ligjit nr.142/2016, krijimin me ligj të Autoritetit Rregullator Hekurudhor (Autoriteti).

Deri më tani, në Shqipëri nuk ka pasur një autoritet rregullator në kuptimin e legjislacionit evropian.

Objektivi specifik i këtij projektligji është rregullimi i tregut dhe konkurrencës së lirë në transportin hekurudhor si dhe nxitja e subjekteve private për të marrë pjesë në zhvillimet e këtij tranporti në Shqipëri.

Përsa më sipër, ftohen grupet e interesit të dërgojnë komentet/rekomandimet brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

**Dokumenta:**

- Projektligji
- Relacioni
- Raporti i Vleresimit te Ndikimit

## Diskutimet